

dialogu qeveridorë

Buletin Informativ – Mars 2011, Botimi nr. 48

Përpjekje e përbashkët e Departamentit të Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj dhe Sekretariatit Teknik të Donatorëve

www.dsdcd.gov.al

www.aidharmonisation.org.al



Foto: Ministria e Integritimit, Majlinda Bregu dhe Ambasadori i Delegacionit të BE-së, Ettore Sequi, nënshkruajnë Marrëveshjen e Financimit të IPA 2010

BE-ja dhe Shqipëria nënshkruajnë Marrëveshjen e Financimit të IPA 2010

Gjatë dy viteve të ardhshme, qeveria shqiptare do të mund të përftojë 83.2 milion Euro ndihmë nga BE në mbështetje të përpjekjeve për përmirësime në fusha strategjike. Financimi do të shkojë për prokurorinë shqiptare, sistemin penitenciar, Parlamentin, rrugët rurale përfshi rrugët e dëmtuara nga përmbytjet në Shkodër, sistemet e ujësjellës-kanalizimeve punësimin, sigurinë ushqimore dhe mjedisin. Fushat ku do të ndërhyhet janë përcaktuar përmes dialogut të vazhdueshëm me qeverinë, shoqërinë civile dhe donatorët e tjerë me synimin që të adresohen disa nga problemet e evidentuara në Raportin Analitik të nentorit 2010. Marrëveshja u nënshkrua nga Ministria e Integritimit, Majlinda Bregu dhe Shefi i Delegacionit të BE-së në Tiranë, Ettore Sequi, gjatë një ceremonie të rastit më 24 mars 2011. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, Ministria Bregu deklaroi: “Prej vitit 2007 deri në 2013-ën, vendi ynë do të mbështetet nga ky instrument financiar duke synuar forcimin e institucioneve demokratike dhe shtetit të së drejtës, reformimin e administratës publike, kryerjen e reformave ekonomike, respektimin e të drejtave të njeriut si dhe të minoriteteve, promovimin e barazisë gjinore, mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile dhe avancimin e bash-

këpunimit rajonal”. Shefi i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, ambasadori Ettore Sequi theksoi se “rregullsia me të cilën BE jep ndihmë për Shqipërinë tregon seriozitetin me të cilin e kemi marrë angazhimin tonë për të ardhmen evropiane të Shqipërisë. Në këtë frymë miqësie, Bashkimi Evropian beson se është e një rëndësie thelbësore që Shqipëria të angazhohet në mënyrë efektive në rrugën e saj drejt integritimit evropian dhe që kjo do t'i hapë rrugë reformave të nevojshme për të mirën e të gjithë njerëzve të këtij vendi dhe të ardhmës së tyre”, tha ai, duke shtuar se “nga kjo pikëpamje, me të njëjtën frymë miqësie, BE beson se zgjedhjet e ardhshme do të zhvillohen në mënyrë dinjitoze. Ne besojmë që Kodi Zgjedhor do të vihet në zbatim në mënyrën e duhur, dhe po ashtu do të zbatohen plotësisht rekomandimet e bëra nga ODHIR që mund të përmirësojnë në mënyrë të menjëhershme praktikatat zgjedhore, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me besueshmërinë e një fushate të ndershme dhe rezultateve të sakta të zgjedhjeve”.

Marrëveshja e Financimit IPA 2010 do të financojë 10 projekte kryesore të grupuar në tre akse prioritare strategjike, konkretisht: Prokuroria do të mbështetet me 3 milion uro për modernizimin e sistemeve të saj të informacionit dhe komunikimit. In-

frastruktura dhe kapacitetet e Burgjeve dhe të Policisë do të përmirësohen nëpërmjet një ndihme prej 18,2 milion eurosh. Kuvendi do të përftojë nga një projekt binjakëzimi prej 1,5 milion eurosh për procesin e përfundimit të legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së dhe për përmirësimin e rolit mbikëqyrës dhe menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore. Infrastruktura do të financohet fuqishëm. Në fokus do të jenë zonat rurale, me 20 milion euro të angazhuar për rrugët rurale dhe 1,5 milion euro për rindërtimin e rrugëve të dëmtuara në zonat e përmbytura të Shkodrës. Përmirësimet në menaxhimin e ujërave dhe trajtimin e ujërave të ndotur e të zeza do të mbështeten me 26 milion euro, konkretisht sistemet e ujërave në Velipojë, Elbasan, Berat, Korçë, Kuçovë, Lushnjë, Fier dhe Sarandë. Infrastruktura e sigurisë ushqimore do të mbështetet me 4 milion euro. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit do të mbështeten me 3 milion euro që të promovojnë më mirë punësimin dhe të rrisin aftësitë dhe mundësitë e punësimit të fuqisë punëtore. Kapacitetet e Ministrisë së Mjedisit do të mbështeten me 4 milion euro për përmirësimin e shërbimeve inspektuese të Ministrisë dhe për fuqizimin e Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit.

Në këtë numër:

- BE-ja dhe Shqipëria nënshkruajnë Marrëveshjen e Financimit të IPA 2010
- Banka Botërore dhe Shqipëria eksplorojnë mundësitë e rritjes së rezistencës së bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike
- Ambasadori amerikan dhe Kryeministri shqiptar përurojnë Qendrën e Shërbimit për Tatimpaguesit në Tiranë
- Kooperacioni Italian financon linjën e re të transmetimit të tensionit të lartë
- Rrjeti i grave kërkon përkrahjen e Presidentit për ekuilibrin gjinor në zgjedhje
- Konferenca kombëtare për Barazinë gjinore dhe qeverisjen vendore
- Perspektiva të reja për Zhvillimin rajonal në qarqet e Shkodrës dhe Lezhës
- Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore organizon Konferencën e Fundit Kombëtare
- Grupet Sektoriale të Punës për Turizmin dhe AFP-në
- Promovohen shembuj të përfshirjes së romëve
- Vizitë e Drejtorit Rajonal të UNICEF-it për Evropën Qendrore e Lindore dhe Komonuelthit të Shteteve të Pavarura
- Gjermania mbështet ekonominë krijuese



Mesazh nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Të dashur lexues,

Kam kënaqësinë të ndaj me ju zhvillimet më të fundit në kuadrin e bashkërendimit të ndihmës së huaj ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si përfituese dhe komunitetit të donatorëve, si edhe në lidhje me programimin afatshkurtër dhe afatgjatë të ndihmës për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është përfituese e projekteve të ndryshme të financuara nga BE, USAID dhe IFAD. Dëshiroj të përmend edhe fundin e emergjencës të dhënë nga Banka Botërore në mbështetje të ndërhyrjeve imediate në zonat e Shkodrës dhe Lezhës pas përmytjeve të rënda këtë fillim viti, si edhe grantin për studimin e fizibilitetit në këto zona. Mjaft arritje pozitive janë shënuar vitin e fundit në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, falë përpjekjeve të përbashkëta të projekteve të ndryshme dhe të stafit të Ministrisë.

Drafti i Programit IPARD është përgatitur dhe i është dërguar Brukselit në fund të shkurtit 2011. Ky program bazohet në analizën horizontale të sektorit bujqësor e rural dhe në analizën vertikale të fushave kyçe si produktet e baxhos, mishi, frutat dhe perimet. Programi mbështet edhe konsolidimin e Agjencisë së Pagesave dhe përgatitjet për akreditim.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është agjenci e re që tashmë funksionon në rang kombëtar, me 48 punonjës në zyrat qendrore dhe 12 zyra rajonale me 267 punonjës gjithsej. Autoriteti Kombëtar i Ushqim-

it do të realizojë funksionet inspektuese, ndërsa MBUMK do të vazhdojë të jetë përgjegjëse për politikëbërjen dhe hartimin e legjislacionit në këtë fushë.

Krijimi i regjistrit të fermave me kod unik, në përputhje me kërkesat e BE-së, është një aktivitet shumë i rëndësishëm për problemin që trajton dhe produktin që do të gjenerojë. Krijimi i këtij regjistri administrativ do të jetë vendimtar për Sistemin e Integruar të Administrimit dhe Kontrollit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AzhBR) dhe do t'i garantojë agjencisë kushte normale për administrimin dhe kontrollin e aplikimeve, në pajtim me procedurat e brendshme dhe ato të IPARD-it.

Janë hartuar disa ligje që janë paraqitur për konsultim apo miratim, siç është Ligji për Veterinarinë, Ligji për Ushqimin, Ligji për Kooperativat në Shqipëri, si edhe akte nënligjore pjesërisht apo plotësisht të harmonizuara me legjislacionin e BE-së për Sigurinë Ushqimore; vlen të përmendet miratimi i Paketës së Higjienës dhe miratimi i procedurave për stabilimentet e produkteve ushqimore në bazë të Analizës së Rreziqeve dhe të Pikave Kritike të Kontrollit).

Për prioritetet e periudhës 2011-2014, dëshiroj të nënvizoj:

Prioriteti kryesor i MBUMK mbetet mbështetja e sektorit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Duke marrë parasysh rekomandimet e evidentuara në Raportin Analitik 2010 dhe Opinionin e Komisionit Evropian si edhe në dokumentet strategjike, Ministria ka dorëzuar për miratim një projekt-propozim në kuadrin e IPA 2011 që parashikon financimin e 10 milion eurove nga fondet e BE-së në mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Protokolli 2010-2012 ndërmjet Qeverive të Shqipërisë dhe Italisë po realizo-

het përmes programimit të përpiktë të tre projekteve me shumë 10 milion euro hua e butë, që synon të mbështesë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural në: krijimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit si kusht i rëndësishëm për zbatimin e IPARD-it, ngritjen e një sistemi Sigurimi të Subvencionuar të Bujqësinë në Shqipëri, dhe prodhimin e përpunimin e vajit të gatimit dhe vajit të ullirit. Po vazhdon bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet ekspertëve italianë të Ministrisë italiane për Politikat Bujqësore, Pyjet, Administrimin e Ujërave dhe Peshkimin dhe ekspertëve të MBUMK-së.

Aktualisht po negociojmë me Bankën Botërore dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare që të vënë në dispozicion një hua prej 40 milion USD për të mbështetur Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe Mbrojtjen nga Përmbytjet.

Sektori i bujqësisë mbetet prioritet edhe për BE-në, siç pasqyrohet edhe në MIPD 2009-2011 (Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar 2009-2011) dhe në vitet në vazhdim presim të kemi mbështetje të vazhdueshme financiare nga IPA 2012 dhe IPA 2013, si edhe nga donatorët e tjerë. Prioritetet afatmesme për t'u adresuar përfshijnë: forcimin e kapaciteteve njerëzore të MBUMK-së; konsolidimin e mëtejshëm të Agjencisë së Pagesave; programimin e Zhvillimit Rural 2014-2020; përmirësimin e standardeve të Sigurisë Ushqimore dhe forcimin e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve. Kam bindjen se me përpjekje të bashkërenduara dhe me idetë e reja që ndajmë në takimet e përbashkëta të Grupeve Sektoriale të Punës, do të sjellim mundësi të reja për të mbështetur më tej sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Ju uroj suksese në përpjekjet tuaja të përditshme.

Genc Ruli

Ministër i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Banka Botërore dhe Shqipëria eksplorojnë mundësitë e rritjes së rezistencës së bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike

Banka Botërore, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) po punojnë së bashku për të rritur rezistencën e bujqësisë ndaj ndryshi-



■ Foto: Zv Menaxherja për vendin e Bankës Botërore, Greta Minxhozi, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Fatmir Mediu, Menaxherja e Bankës Botërore për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural për rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore, Dina Umali-Deiningger, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Genc Ruli në konferencën e nivelit të lartë që u organizua në 3 mars 2011

meve klimatike, në kuadrin e Programit Rajonal për Uljen e Cenueshmërisë të Sistemeve Bujqësore të Evropës dhe Azisë Qendrore nga Ndryshimet Klimatike. Nga ky bashkëpunim, është realizuar një analizë e thelluar e impaktit të pritshëm të ndryshimeve klimatike në bujqësi dhe janë identifikuar politikat kyçe të adaptimit, programet dhe investimet që mund të ndihmojnë në uljen e cenueshmërisë së sektorit bujqësor përballë ndryshimeve klimatike. Në kuadër të këtij programi, më 3 mars 2011, Banka Botërore, MBUMK dhe MMPAU organizuan bashkërisht në Tiranë Konferencën Kombëtare të Nivelit të Lartë për Shpërndarjen e Informacionit dhe Arritjen e Konsensusit. Ky eveniment ishte hapi i fundit i programit për Uljen e Cenueshmërisë së Sistemeve Shqiptare Bujqësore përballë Ndryshimeve Klimatike që filloi zyrtarisht në maj 2009. “Nisur nga përvoja e të dhënat e grumbulluara si dhe analizat dhe vlerësimet e bëra, ndryshimet e pritshme klimatike ndikojnë ndjeshëm sidomos në sigurimin e ushqimit nga popullsia e varfër rurale dhe në rritjen ekonomike të zonave më vulnerabel. Në të njëjtën kohë, këto ndryshime mund të krijojnë edhe mundësi të reja për fermerët në zona apo mikrozona agro-klimatike dhe vendi ynë është një shembull tipik për larminë e tyre në raport me madhësinë e territorit”, tha Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Genc Ruli. Gjatë dy viteve të zbatimit të këtij programi, është zhvilluar një Seminar Kombëtar Ndërgjegjësimi dhe Konsultimi, janë hartuar dy studime për Bujqësinë dhe Ndryshimin e Klimës në Shqipëri, janë zhvilluar shumë konsultime me fermerët në të katër zonat agro-ekologjike në Shqipëri dhe është nxjerrë një Projektvlerësim i Efektit dhe Menysë së Mundësive për Përshtatje

për sistemet bujqësore shqiptare.

Projekti u diskutua me partnerët dhe aktualisht, në bashkëpunim me MBUMK, po prioritetizohen dhe po finalizohen rekomandimet kyçe për politikat, programet dhe investimet. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Fatmir Mediu, u shpreh: “Komunikimi i Dytë Kombëtar (KDK) i Shqipërisë i publikuar në vitin 2009, - si detyrim ndaj Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike - përfaqëson dokumentin kryesor të politikave që vlerëson ndikimin e ndryshimeve klimatike. Ndërkohë Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka filluar përgatitjet për hartimin e Komunikimit të Tretë Kombëtar, ku kërkohet përfshirja dhe bashkëpunimi sidomos i sektorëve të energjisë, industrisë, bujqësisë, pyjeve, mbetjeve dhe transportit”. Menaxherja Sektoriale e Bankës Botërore për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural në rajonin Evropës dhe Azisë Qendrore deklaroi: “Përmbytjet rrënuese të kohëve të fundit në Shqipëri e vënë theksin te cenueshmëria e sektorit bujqësor nga luhajtjet dhe ndryshimi i klimës në vend dhe nënvizojnë nevojën për të vënë në jetë masat e duhura për përshtatjen për të ndihmuar në uljen e kësaj cenueshmërie”.

Parashikimet e klimës tregojnë se temperaturat në Shqipëri do të rriten, ndërsa reshjet do të pakësohen dhe do të bëhen më të luhatshme, duke çuar në rritjen e numrit të ngjarjeve ekstreme siç janë përmbytjet dhe thatësira, si dhe në rënie të rendimentit bujqësor të parashikuar, sidomos për vreshtat dhe ullinjët. Këto ndryshime mund të prekin ndjeshëm sistemet bujqësore dhe të kenë ndikim negativ në jetesën e popullsisë rurale. Efektet e parashikuara të ndryshimit të klimës theksojnë nevojën për të hartuar dhe zbatuar masa të cilat mund ta

rrisin rezistencën e bujqësisë ndaj rreziqeve klimatike në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë. Programi ka punuar për të identifikuar masa me efekte pozitive të menjëhershme në sistemet bujqësore vendase, duke iu përshtatur, në të njëjtën kohë, parashikimeve të ardhshme klimatike, duke krijuar alternativa dhe rekomandime nga të cilat vetëm mund të fitosh. Ky program administrohet nga Banka Botërore dhe mbështetet me grante të Bankës Botërore, Partneritetit Bankë Botërore-Holandë dhe Fondit të Besimit për Zhvillim të Qëndrueshëm Social dhe Mjedisor.



Foto: Ambasadori i SHBA-së, Alexander Arvizu dhe Kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, përurorjnë Qendrën e re të Shërbimit për Tatimpaguesit në Tiranë

Ambasadori amerikan dhe Kryeministri shqiptar përurorjnë Qendrën e re të Shërbimit për Tatimpaguesit në Tiranë

Më 1 mars 2011, Ambasadori i SHBA-së, Aleksandër A. Arvizu dhe Kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, përuroruan Qendrën e re të Shërbimit për Tatimpaguesit në Tiranë. E krijuar me ndihmën e popullit amerikan nëpërmjet Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, Faza II, qendra ofron shërbime tatimore dhe informacion për të gjitha bizneset që operojnë në Tiranë. Qendra u hap më 1 dhjetor 2010 dhe që atëherë e vizitojnë rreth 1 000 tatimpagues në ditë. Që prej hapjes, qendra u ka shërbyer pothuajse 50 000 klientëve. Qendra e re krenohet me 19 sportele shërbimi për klientët, sistemin e teknologjisë së informacionit që lidhet me bazën e të dhënave të tatimpaguesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe zyrave të tjera tatimore, si dhe sistemin e menaxhimit të radhës i ndërtuar sipas teknologjisë së fjalës së fundit. Projektimi novator i Qendrës pakëson radhët e gjata për tatimpaguesit, u ofron atyre një nivel më të lartë shërbimi, si dhe mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit të biznesit në Shqipëri. Qendra përfshin një zyrë që u shërben bizneseve me seli në Tiranë dhe një tjetër që u shërben 800 tatimpaguesve të mëdhenj në Shqipëri. Programi ka krijuar gjithashtu një Linjë Telefonike për Tatimpaguesit dhe mbështet administratën tatimore në mbledhjen e të ardhurave si dhe ofron informacion për tatimpaguesit.

BE ndihmon në modernizimin e Administratës Tatimore shqiptare

Projekti prej 2,2 milion eurosh i financ-

uar nga BE-ja ka sjellë në Shqipëri ekspertizën e Shteteve Anëtare për të ndihmuar në plotësimin e legjislacionit tatimor dhe përmirësimin e praktikave të punës, për t'i sjellë në përputhje me ato të BE-së. Projekti synon të përmirësojë përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe efikasitetin e transparencën e administratës tatimore, në funksion të bizneseve të ligjshme dhe publikut të gjerë. Projekti konsolidon përmirësimet progresive të arritura në të kaluarën dhe përmban objektiva dhe aktivitete të konceptuara enkas për nevojat specifike të Shqipërisë. Ky projekt binjakëzimi mes autoriteteve shqiptare, Agjencisë Tatimore Suedeze dhe Drejtorisë së Përgjithshme franceze të Financave Publike, po sjell në Shqipëri ekspertë nga Shtetet Anëtare (i) për të plotësuar legjislacionin fiskal dhe për ta harmonizuar me legjislacionin e BE-së; (ii) për të ngritur procedurat e Auditit të Brendshëm të harmonizuara me standardet e BE-së, (iii) për të mbështetur Drejtorinë e Hetimit Tatimor, (iv) për të krijuar një Departament Teknologjie Informacioni shumë funksional, dhe (v) të përmirësojë ndërlidhjen mes të gjitha degëve rajonale përmes një rrjeti të sigurt dhe të besueshëm. Gjatë ceremonisë së prezantimit më 21 mars 2011, Shefi i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Ambasadori Etore Sequi u shpreh se procedurat tatimore transparente e efçente janë një bazament i rëndësishëm i Tregut të Brendshëm të BE-së, një treg i gjerë ku rregullat e lojës janë të qarta, të respektuara dhe të favorshme për biznesin. Ai theksoi se "Asistenca e BE-së për të përmirësuar sistemin fiskal të Shqipërisë në përputhje me standardet e BE-së është e rëndësishme në kuadrin e integritimit të Shqipërisë në familjen e BE-së. Procedurat më transparente dhe efçente janë në të

mirë të bizneseve dhe qytetarëve që paguajnë rregullisht taksat me pritshmërinë se në shkëmbim do të marrin shërbime publike. Në të njëjtën kohë, këto sisteme moderne do të ndihmojnë në luftën kundër korrupsionit dhe do të vendosin kushte të barabarta në treg për bizneset, duke garantuar kështu konkurrencën e ndershme". Ky projekt filloi më 1 mars dhe do të vazhdojë deri në shkurt 2012.

USAID mbështet Industrinë e Veshmbathjeve të Shqipërisë

Shoqëritë tregtare të veshmbathjeve janë zgjeruar dhe e kanë konsoliduar ekspertizën vitet e fundit; shumë prej tyre kërkojnë të diversifikojnë shërbimet që ofrojnë dhe të rrisin kapacitetet për të pasur cikël të plotë prodhimi që përfshin dizejnimin, fabrikimin dhe grumbullimin e lëndës së parë, prerjen dhe qepjen. Ky cikël i plotë u mundëson sofistikim më të lartë në treg, rroga më të mira për punëtorët dhe forcim të këtij sektori të rëndësishëm. USAID po ndihmon shoqëritë e veshmbathjeve të rritin efikasitetin e fabrikave të tyre, si dhe të zhvillojnë dhe të tregtojnë cilësinë dhe profesionalizmin e tyre dhe të prodhonte që prodhojnë. Në vitin e kaluar, qindra shoqëri kanë marrë pjesë në seminare dhe takime pune për rritjen e prodhueshmërisë, të cilat janë organizuar nga programi i USAID-it për zhvillimin e ndërmarrjeve konkurruese me qëllimin që të mësojnë si të përmirësojnë aktivitetin tregtar. USAID dërgon konsulentë dhe ekspertë të fushës që të punojnë bashkërisht me shoqëritë dhe ka sponsorizuar shumë kompani për të marrë pjesë në panairë tregtare rajonale, që ato të shtojnë



Foto: Një prej kompanive të industrisë së veshjeve e mbështetur nga USAID

kontaktet tregtare dhe të integrohen në rrjete. Muajin që vjen, shoqata e biznesit e kësaj industrie do të lançojë faqen e interneti të Industrisë shqiptare të Veshmbathjeve. Për të parë një nga shoqëritë tregtare që po ndihmohet nga USAID, konkretisht fabrikën e veshmbathjeve “Anisa & Noemi” në Durrës, mund të shihni “Anisa& Noemi” Garment Factory, Durrës, Albania (March 18, 2011) në [YouTube USAID/Albania You Tube Channel](#).

Rrjeti i grave i mbështetur nga OSBE kërkon përkrahjen e presidentit për ekuilibrin gjinor në zgjedhje

Më 8 mars 2011, një grup prej 40 grash shqiptare pjesëmarrëse në projektin e Prezencës së OSBE-së për barazinë gjinore në Shqipëri i kanë kërkuar mbështetje presidentit Topi për të garantuar pjesëmarrjen e grave në listat e kandidatëve për zgjedh-

jet vendore. Grupi përfaqëson Platformën Kombëtare të Grave, një rrjet informal vullnetar prej 500 grash nga partitë politike dhe shoqëria civile. Ky rrjet është krijuar në kuadër të një projekti 3-vjeçar të Prezencës së OSBE-së për të shtuar pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike. Projekti financohet nga Holanda dhe Suedia. Gjatë takimit, përfaqësueset e Platformës i dorëzuan Presidentit një deklaratë ku u bëhej thirrje partive politike, zyrtarëve të zgjedhur, deputetëve dhe institucioneve shtetërore e publike, të respektojnë dhe të përmirësojnë dispozitat juridike për barazinë gjinore, sidomos kuotën 30% të grave për zgjedhjet parlamentare dhe vendore. Gjithashtu, ato kërkuar që kuota të zgjerohet duke u aplikuar edhe në zgjedhjet për kryetarë bashkie dhe në komisionet zgjedhore, dhe propozuan sanksione më të ashpra për shkeljet e Kodit Zgjedhor. Platforma Kombëtare e Grave kërkoj edhe që listat e kandidatëve t’i nënshtrohen debatit publik, para se të miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.



Foto: Rrjeti i grave i mbështetur nga BE i kërkon Presidentit Bamir Topi mbështetje për ekuilibrin gjinor në zgjedhje

Kooperacioni Italian financon linjën e re të transmetimit të tensionit të lartë Elbasan-Tiranë

Më 14 mars 2011, Kryeministri Sali Berisha dhe Ambasadori italian, Saba D’Elia përruruan linjën e re të transmetimit 400 kV që lidh Elbasanin me Tiranën. Ndërtimi i kësaj linje elektrike 50 km të gjatë është finalizuar nga “SAE Power Line Ltd” dhe “Terna Jsc”, dy shoqëri italiane pararojë në botë në sektorin e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Linja e tensionit të lartë Elbasan-Tiranë është pjesë e një programi më të gjerë investimesh që Kooperacioni Italian po



Foto: Kryeministri Sali Berisha dhe Ambasadori italian Saba D’Elia në ceremoninë përruese të linjës Elbasan-Tiranë

financon me qëllim rritjen e efijencës dhe besueshmërisë së sistemit elektrik shqiptar dhe lidhjen e tij me rrjetin rajonal të transmetimit. Programi italian për sektorin e energjisë kap vlerën 90 milion euro në hua të buta: gjysma e kësaj shume është lëvruar tashmë për të mbuluar kostot e ndërtimit të linjës Elbasan-Tiranë dhe infrastrukturën shtesë si Qendra e re Dispeçer dhe Nënstacioni Tirana 2. Kryeministri Sali Berisha i shprehu mirënjohjen Kooperacionit Italian për ndihmën e dhënë me këtë projekt. Ambasadori italian Saba D’Elia shprehu dëshirën për të rritur investimet dhe për të forcuar partneritetin italo-shqiptar në fushën e energjisë, për të kontribuar kështu në shndërrimin e Shqipërisë në një aktor me peshë në tregtinë rajonale të energjisë.

Konferenca “Barazia gjinore dhe qeverisja vendore” prezanton praktikat më të mira



100 përfaqësues të pushtetit qendror e vendor, partnerë vendorë dhe donatorë u mbledhën më 15-16 mars në Tiranë për të diskutuar dhe shkëmbyer praktikat më të mira të pushtetit vendor në adresimin efikas të të drejtave dhe nevojave të burrave dhe grave. Konferenca “Barazia gjinore dhe qeverisja vendore” u organizua nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në bashkëpunim me organizatën e OKB-së “UN Women” dhe me Programin “Barazia në Qeverisje” financuar nga qeveria austriake. Në këtë eveniment përshëndetën Shkëlqesia e Tij, Ambasadori austriak Florian Raunig dhe znj. Heba El Kholy, E ngarkuar me Punë e “UN Women”. Pjesëmarrësit shkëmbyen shembuj të suksesshëm nga Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia, si dhe diskutuan për ndryshimet që duhen bërë në politika, buxhete dhe burimet njerëzore, me qëllim ofrimin e shërbimeve më të mira dhe më të ndjeshme në aspektin gjinor. Zv. Ministri i Brendshëm, Ferdinand Poni, u shpreh se “kjo konferencë është e suksesshme sepse synon të llojë për një çështje kaq të rëndësishme që nuk duhet konsideruar si ‘çështje e grave’, pasi ndikon, forcon dhe përkufizon qeverisjen e mirë dhe efikase, duke i shtuar një tjetër dimension pjesëmarrjes publike në nivelin vendor”. Synimi i Kon-



Foto: Konferenca “Barazia gjinore dhe qeverisja vendore”

ferencës ishte të inkurajonte vendimarrësit vendorë dhe qendrorë që të aplikojnë praktikat e suksesshme, si dhe të integrojnë çështjet e barazisë gjinore në të gjithë programet dhe politikat e tyre publike. Përvojat e pasura dhe të shumëllojshme që u prezantuan në konferencë, bashkë me metodologjitë kryesore për integrimin gjinor në pushtetin vendor, shpejt do të përmbliidhen në një publikim të veçantë që do të shpërndahet gjerësisht dhe do të afishohet në faqet e internetit të organizatave përkatëse.

Perspektiva të reja për Zhvillimin rajonal në qarqet e Shkodrës dhe Lezhës

Austria dhe Zvicra japin 4 milion euro për financimin e një programi të zhvillimit rajonal i cili do të ndihmojë qarqet e Shkodrës dhe Lezhës në zhvillimin e barabartë social dhe ekonomik nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të projekteve në dobi të këtyre

dy qarqeve dhe forcimin e kapaciteteve zhvilluese të tyre. Aktiviteti promovues i zhvilluar më 8 mars 2011 shënoi fillimin e Programit të Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë e Veriut i financuar nga Austria dhe Zvicra. Evenimenti u drejtua nga Ambasadorët e Austrisë dhe Zvicrës dhe drejtuesit e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe të Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran, dhe me pjesëmarrësit e përfaqësuesve kryesorë të DEBASKON-it dhe ministritë e linjës. «Sfidat e zhvillimit rajonal mund të përballohen vetëm përmes mbështetjes së vazhdueshme për procesin e decentralizimit», tha në fjalën e saj Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler që thekoi edhe faktin se programi i ri do të punojë krahas programeve të tjera të cilat synojnë forcimin e pushtetit vendor dhe promovimin e ndryshimeve rajonale. «Ne po e financojmë dhe zbatojmë programin e zhvillimit rajonal së bashku me Zvicrën, një vend partner i cili, ashtu si Austria, gëzon një histori të gjatë të zhvillimit të suksesshëm rajonal», tha Ambasadori austriak, Shkëlqesia e tij z. Florian Raunig. Ai shtoi se përvoja austriake dhe zvicerane në këtë fushë do të kontribuojnë për zhvillimin e qëndrueshëm të një rajoni Ballkani që ofron potencialin dhe mundësitë më tërheqëse. Aktiviteti vijoi me fjalime nga Kryetarët e qarqeve të Shkodrës dhe Lezhës dhe me një sesion me pyetje-përgjigje. Programi do të përdorë disa instrumente me qëllim që të kontribuojë drejt zhvillimit të barabartë social dhe ekonomik në Shkodër dhe Lezhë, duke përfshirë një fond prej 2 milion eurosh që do të financojë hartimin dhe zbatimin e projekteve me impakt në zhvillimin rajonal. Programi do të përmirësojë aftësitë e dy qarqeve për të përfutur fonde



Foto: Konferenca Kombëtare prezanton Përvojat dhe Praktikrat më të Mira të Pushtetit Vendor të Shkodrës dhe Lezhës.

zhvillimit nga burimet e disponueshme kombëtare dhe ndërkombëtare, do të ofrojë asistencë teknike dhe asistencë për forcim kapacitetesh, si edhe do të ndikojë në politikat e pushtetit qendror dhe vendor.

Konferenca kombëtare prezanton Praktikën më të Mirë të Shkodrës dhe Lezhës

Zyra Zvicerane për Bashkëpunim dhe Ministria e Brendshme mblodhën së bashku aktorët kyç në decentralizim dhe qeverisjen vendore për të shkëmbyer praktikën dhe përvojat e tyre më të mira si dhe mësimet e nxjerra. Për përfaqësuesit e bashkive dhe të komunave, u prezantuan metoda të reja të planifikimit strategjik, menaxhimit financiar dhe informimit publik, të krijuara me mbështetjen e Programit për Decentralizim dhe Zhvillimin Vendor (DLDP). Ky eveniment u zhvillua në kuadër të mbështetjes zvicerane për procesin e decentralizimit dhe fuqizimin e njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri. Mes të ftuarve speciale në konferencë ishin Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler, zv.Ministri i Brendshëm, z. Ferdinand Poni dhe Drejtori i Bashkëpunimit Zviceran për Shqipërinë, z. Daniel Züst. Pjesëmarrësit përfshinin përfaqësues të pushtetit qendror e vendor, të donatorëve ndërkombëtare, të OJF-ve dhe ekspertë vendorë. Evenimenti u zhvillua më 3 mars 2011 dhe përfshinte një seancë me fjalime e prezantime dhe një seancë me diskutime të hapura në tryeza të rrumbullakëta, që rezultuan në disa rekomandime për politikën. “Disa praktika të mira në fushën e decentralizimit mund t’i gjejmë në përvojën zvicerane dhe në vende të tjera gjithashtu. Po ajo çfarë është më rëndësishmja dhe ajo çfarë duam të promovojmë sot, janë edhe praktikën dhe përvojat më të mira të arritura këtu, në Shqipëri”, tha Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler. Ajo shtoi gjithashtu se progresi i Shqipërisë drejt një demokracie të plotë, varet shumë nga decentralizimi dhe fuqizimi i bashkive dhe komunave”. Pjesëmarrësit u njohën me një sërë publikimesh të bëra në kuadrin e projektit DLDP (<http://www.dldp.al>) për përdorim nga bashkitë dhe komunat për konsolidimin e njohurive. Evenimenti u shërbeu pjesëmarrësve nga qarqe të ndryshme si platformë e dobishme për shkëmbimin e ideve në lidhje me një sërë praktikash të suksesshme të konstatuara në Shqipëri.



Foto: Lançimi i Programit të Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë e Veriut me financim të Austrisë dhe Zvicrës

Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri Organizon Konferencën e Fundit Kombëtare

Më 23 mars 2011, Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri organizoi një konferencë kombëtare me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të njësive të qeverisjes vendore, organizatave joqeveritare dhe ndërmarrjeve të sektorit privat për të prezantuar dhe diskutuar praktikën më të mira në mbështetje të mirëqeverisjes dhe të rritjes ekonomike në bashkitë e vendit. Që prej vitit 2007, Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA) ka punuar me dhjetë bashki në një sërë aktivitetsh që nxisin rritjen e ekonomisë vendore, përmirësimin e qeverisjes vendore dhe forcimin e përfshirjes së shoqërisë civile dhe

të sektorit privat në zhvillimin vendor. Projekti realizoi praktikën e kompjuterizuara për administrimin e tatim-taksave vendore në 10 bashki, mundësoi fillimin e huamarrjes vendore për 8 bashki për financimin e projekteve të mëdha infrastrukturore, ndihmoi bashkitë të regjistrojnë dhe të administrojnë rreth 3 300 prona vendore, si dhe përpiloi plane të plota territoriale për Bashkinë e Kukësit dhe të Fushë-Krujës. Përmes këtyre veprimtarive, njësitë e pushtetit vendor mund të përmirësojnë shërbimet që u ofrojnë qytetarëve dhe të jenë më reaguese ndaj tyre. Në këtë konferencë ishin të pranishëm dhe morën pjesë në panele diskutimi kryetarët e 10 bashkive të ndihmuara nga USAID dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare e të ndërmarrjeve të sektorit privat, të përfshira në partneritete publik-privat nën udhëheqjen e USAID-it. Për më tepër informacion rreth Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore, shikoni: [USAID/Albania's You Tube Channel](#).



Foto: Z. Viktor Tushaj, Kryetar i Bashkisë së Lezhës, duke drejtuar një panel diskutimi për modernizimin e departamentit të administratës tatimore vendore gjatë Konferencës Kombëtare për Qeverisjen Vendore

Grupi Sektorial i Punës për Arsimin dhe Formimin Profesional

Grupi Sektorial i Punës për Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) u mbledh më 21 mars 2011 në takim e organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me DEBASKON-in, Zyrën e Bashkëpunimit Zviceran dhe partnerë donatorë pjesëmarrës në Grupin Sektorial të Punës. Qëllimi ishte përcaktimi dhe diskutimi i prioritetëve dhe sfidave kryesore në fushën e punësimit të të rinjve, duke u përqendruar në periudhën tranzitore mes shkollës dhe punësimit. Diskutimet u fokusuan në prioritetet e përcaktuara nga Plani Kombëtar i Veprimit për Punësimin e Të Rinjve. Ky Plan është përgatitur nga një grup pune i kryesuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me mbështetjen e Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe Programit të Punësimit dhe Migrimit të të Rinjve (Programi YEM). Gjithashtu, u prezantua Pakti Territorial për Punësimin për Qarkun e Kukësit, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me të rejtat dhe rezultatet e Programit Operacional për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore.

Takimin e hapi zv.Ministri i Punës, Kasriot Sulka, i cili nënvizoi se kjo është një mundësi e mirë për të prezantuar Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë dhe Qarkun e Kukësit - Pakti Territorial për Punësimin, i pari i këtij lloji në Ballkan. Ai theksoi rëndësinë e Planit Kombëtar të Veprimit dhe shpjegoi se si ky plan bashkon objektivat e punësimit të rinisë shqiptare në një kuadër koherent të harmonizuar me të gjitha politikat e Qeverisë për punësimin, arsimin, zhvillimin sektorial, tregtinë, etj. Z.Sulka vuri në dukje se mbështetja e donatorëve ka qenë vendimtare për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit. Zv.Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Halit Shamata, shtoi se Ministria e tij është vazhdimisht e angazhuar në rritjen dhe forcimin e sistemit AFP. Disa nga çështjet e ngritura prej pjesëmarrësve ishin: forcimi i bashkëpunimit në arsim dhe sektorë të tjerë në qarkun e Kukësit, përgatitja e një harte të donatorëve ku të paraqiten kontributet e mundshme të tyre për arritjen e objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit, si edhe shpërndarja e Programit Operacional donatorëve për të marrë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.



Foto: Grupi Sektorial i Punës për Zhvillimin e Turizmit i ngritur më 4 mars 2011.

Grupi Sektorial i Punës për Zhvillimin e Turizmit

Më 4 mars 2011, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve krijoi me organizatorët Grupin Sektorial të Punës për zhvillimin e turizmit, me qëllim forcimin e bashkërendimit dhe rritjen e financimeve dhe kontributit donator për sektorët që mbulon kjo Ministri. Ideja ishte që të rakordoheshin më mirë prioritetet e Ministrisë me programet e asistencës të ofruara prej donatorëve. Në këtë takim të bashkëkryesuar nga Ministri i Turizmit, Ferdinand Xhaferaj dhe Drejtori i UNDP-së për Shqipërinë, Norimasa Shimomura, morën pjesë përfaqësues të donatorëve aktivë në sektorin e turizmit. Në fjalën e tij, Ministri Ferdinand Xhaferaj theksoi angazhimin e qeverisë për zbatimin e të gjitha prioritetëve në fushën e turizmit dhe të përmirësimeve të nevojshme në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë. Aktiviteti vijoi me një prezantimin e Strategjisë sektoriale të Turizmit 2007-2013 dhe rezultatet e arritura gjatë zbatimit dhe monitorimit të kësaj strategjie. Më pas u prezantua Strategjia e Marketingut Kulturor dhe Nisma “Vizito Shqipërinë – Viti 2012”. Strategjia e Marketingut Kulturor synon të përmirësojë imazhin e Shqipërisë në botë përmes evidentimit dhe promovimit të potencialit turistik dhe të trashëgimisë sonë kulturore. Anëtarët e Grupit Sektorial të Punës paraqitën aktivitetet e tyre në mbështetje të turizmit si edhe elementet që mbështesin turizmin e qëndrueshëm. Në mbyllje, takimi vendosi që të bashkërendohen përpjekjet për të rritur efikasitetin e ndërhyrjeve në fushën e turizmit.

Roli i qytetarëve në rijetëzimin e monumenteve kulturore në Gjirokastrë dhe Berat

Më 17 mars 2011, autoritetet vendore të specializuara në fushën e monumenteve të kulturës, partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtare aktivë në fushën e trashëgimisë kulturore, qytetarë dhe pronarë të shtëpive monument, morën pjesë në përvizimin e projektit për ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve për rolin e tyre në rijetëzimin e banesave historike të Beratit dhe Gjirokastrës. Kryetari i bashkisë së Beratit, Fadil Isufi, falënderoi të gjitha aktorët që kanë qenë pjesë integrale e të gjithë procesit dhe që janë kujdesur për ruajtjen, rijetëzimin dhe restaurimin e vlerave historike dhe trashëgimisë kulturore. “I bëj apel të gjithë qytetarëve të Beratit që të kontribuojnë për trashëgiminë tonë kulturore e cila na bashkon, sepse e shkuara dhe e ardhmja e Beratit janë të lidhura ngushtë me trashëgiminë kulturore”, tha ai.

Projekti parashikon publikimin e një udhëzuesi për metodat e restaurimit, procedurat dhe praktikën më të mira të Shqipërisë. I pranishëm në këtë takim ishte edhe z. Erkan Ozçelik, Koordinator i Programit të Përbashkët të OKB-së për Kulturën dhe Trashëgiminë, i cili deklaroi: “Me përfshirjen e Beratit dhe Gjirokastrës në Listën e Trashëgimisë Botërore, roli i aktorëve vendorë për ruajtjen dhe restaurimin e ndërtesave po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, ndërkohë që turizmi po bëhet një mjet i rëndësishëm jetese për shqiptarët. Në këtë kuptim, ky projekt vjen në kohën e duhur. Natyrisht, një projekt i vetëm nuk mund të zgjidhë të gjitha problemet e akumuluar, por është një hap në drejtimin e duhur. Ndërgjegjësimi i qytetarëve është

një proces i gjatë”. Ndërsa Sadi Petrela, drejtor i Organizatës për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës dhe koordinatori i projektit, u shpreh: “Jemi të ndërgjegjshëm gjithashtu se mendimi mbizotërues është se problemi kryesor në ruajtjen dhe rrijetëzimin e trashëgimisë së ndërtuar është pamjaftueshmëria e investimeve. Por ne mendojmë se përmes ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve, mund të kontribuojmë në mobilizimin e investimeve nga shteti, vetë qytetarët dhe nga biznesi. Ne planifikojmë t’i sjellim më afër këta aktorë të rëndësishëm, për të investuar në rrijetëzimin e Trashëgimisë Kulturore të Ndërtuar”. Projekti zbatohet nga Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës (GCDO) në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit (MKTRS) dhe Institutin e Monumenteve dhe mbështetet nga Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara “Kultura dhe Trashëgimia për Zhvillim Social dhe Ekonomik”. Projekti është financuar nga Fondi Spanjoll për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit – (MDG-F)

Konferenca promovon shembuj të përfshirjes së Romëve në jetën sociale dhe ekonomike dhe i paraqet Rekomandime Qeverisë

Fondacioni Ndhimë për Fëmijët, me mbështetjen e Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri (SCO-A) dhe në bashkëpunim me Sekretariatën e Romëve të Ministrisë së Punës, organizoi sot një konferencë për fuqizimin e romëve dhe përfshirjen e tyre sociale. Ambasadorja zvicerane, Shkëlqesia e Saj Yvana Enzler si dhe zv.Ministret e Arsimit dhe Punës hapën konferencën duke prezantuar disa nga arritjet, si dhe duke bërë thirrje për më shumë veprim, me qëllim përmirësimin e jetës së popullatës rome dhe integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare. Konferenca “Fuqizimi i Romëve: Një Përfaqje për Zhvillim Gjithëpërfshirës”, u mbajt më 31 mars 2011. Evenimenti përfshinte prezantime të shembujve pozitivë të përfshirjes dhe fuqizimit të romëve, identifikoi sfidat dhe hapat e mëtejshëm që duhen ndërmarrë, si dhe paraqiti një listë me rekomandime për qeverinë shqiptare dhe aktorët e tjerë kryesorë. Konferenca ishte një eveniment i rëndësishëm për të rritur ndërgjegjësimin publik rreth fuqizimit të romëve, si një mënyrë për t’i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. “Jam e sigurt që do të kemi më



Foto: Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler, duke mbajtur fjalën në hapjen e Konferencës Kombëtare “Fuqizimi i Romëve: Një përfaqje për Zhvillim Gjithëpërfshirës”

shumë fëmijë romë të shkolluar, më shumë nëna rome të fuqizuara ekonomikisht si dhe më shumë familje rome që gëzojnë një jetë më të mirë, nëse bashkojmë forcat dhe këmbëngulim në detyrën fisnike të fuqizimit të këtij komuniteti”, tha Ambasadorja zvicerane, Yvana Enzler. Ajo theksoi rëndësinë e veçantë që strategjia për zhvillim e Zvicerës i kushton përfshirjes së grupeve të marginalizuara, siç janë romët. Konferenca u mbajt në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve (8 prill), si dhe të Dekadës për Përfshirjen e Romëve 2005-2015, këtij pakti 10-vjeçar mbarevropian që synon integrimin e popullsisë rome në jetën evropiane. Shqipëria është një nga 12 vendet pjesëmarrëse në këtë nismë dhe kjo konferencë ishte ndër aktivitetet më të rëndësishme të organizuara në këtë drejtim.

OSBE, SHBA dhe BE nxisin autoritetet të hetojnë për përzënieën e familjeve rome

Ambasadori Eugen Wollfarth, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Alexan-

der Arvizu, Ambasador i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri dhe Ambasadori Ettore Sequi, Shefi i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, dolën me këtë deklaratë për shtyp më 16 mars 2011 në lidhje me incidentet e kohëve të fundit me familjet rome: “Prezencia e OSBE-së në Shqipëri, Ambasada e SHBA-së në Tiranë dhe Delegacioni i BE-së në Shqipëri janë në dijeni se gjatë javës së datës 20 shkurt 2011, dhjetëra familje rome janë larguar me forcë nga vendqëndrimi i tyre në qendër të Tiranës nga persona të paidentifikuar, të cilët u vunë zjarrin strehëve ku ata jetonin dhe i përzunë nga shtëpitë e tyre... Ne vërejmë se si pasojë e këtyre veprimeve, pati lëndime të rënda dhe një numër i madh njerëzish, duke përfshirë edhe fëmijë, u detyruan të shpërngulen... Ne vërejmë se Shqipëria është angazhuar zyrtarisht të zbatojë objektivat e Deklaratës për Dekadën e Përfshirjes së Romëve dhe ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave... Ne theksojmë se Shqipëria është



Foto: Fëmijë romë

900 kopshte pajisen me biblioteka




Foto: Vendndodhja e 934 bibliotekave të shpërndara në kopshte e parë me Google Earth

“Shqipëria lexon”, një nismë e për-bashkët e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe UNICEF-it, e mbështetur nga OJF partnere, promovon leximin dhe arsimin cilësor parashkollor për fëmijët shqiptarë. Këtë projekt e kanë mbështetur edhe biznese private bujare, vendase dhe të huaja. IKEA, Vodafone, Raiffeisen Bank, AC Milan, Komitetet Kombëtare për UNICEF dhe të tjerë, u bashkuan për t’u sjellë libra fëmijëve. Në mars 2011, 934 kopshte u pajisën me biblioteka me libra cilësorë për fëmijë. Dorëzimi i librave është kontrolluar me kamera të pajisura me GPS dhe mund të shihen në Google Earth, ku identifikohet secila ndërtesë e kopshteve. Më 4 mars 2011, në Rrenc të Shkodrës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Instituti i Arsimit, Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër dhe UNICEF lançuan komponentin e nismës që fokusohet në trajnimin e fëmijëve. 900 mësues do të njihen me praktika të përmirësuara pedagogjike dhe me metodat e të nxënësve aktiv në sistemin parashkollor. Në kuadrin e komponentit paraardhës të kësaj nisme, mbi 1400 shkolla të arsimit të detyruar u pajisën me biblioteka për nxënës.

angazhuar të zbatojë Planin e Veprimit për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom dhe Sintin në Zonën e OSBE-së, si dhe Vendimin e Këshillit Ministror 2009 për Shtimin e Përpjekjeve të OSBE-së për Integrim të Qëndrueshëm të komunitetit Rom e Sintin. Miratimi i këtij vendimi nga Shtetet anëtare të OSBE-së, duke përfshirë edhe Shqipërinë, tregon angazhimin e këtyre vendeve për të luftuar diskriminimin dhe racizmin e treguar ndaj komunitetit rom dhe sintin, përfshi edhe nga mediat... Në Avis për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE, Komisioni Evropian ka identifikuar luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të romëve si fusha prioritare të cilave autoritetet duhet t’u kushtojnë vëmendje të veçantë... Në këtë frymë, ne u bëjmë thirrje autoriteteve përkatëse të ndërmarrin veprimet e duhura për hetimin e ngjarjeve shqetësuese të shkurtit, për të siguruar që veprime të tilla të mos përsëriten më. Ne i inkurajojmë autoritetet të marrin hapat e duhur për t’u dhënë ndihmën e nevojshme sociale, përfshi strehimin, këtyre njerëzve të cilët kanë mbetur të pastrehë... Ne kemi besim që shumica e qytetarëve janë kundër akteve të tilla dhune ndaj këtij minoriti. OSBE, SHBA dhe BE bashkohen me përfaqësuesit e shoqërisë civile në thirrjen për t’i dhënë fund diskriminimit dhe dhunës ndaj familjeve dhe fëmijëve romë”.

Vizitë e Drejtorit Rajonal të UNICEF për Evropën Qendrore e Lindore dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarura

Drejtori Rajonal i UNICEF-it për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarura



Foto: Vizita e Drejtorit Rajonal të UNICEF për Evropën Qendrore e Lindore dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarura



Foto: Z. Steven Allen në qendrën shumëfunktionale "Shtëpia e Ngjyrave"

elthit të Shteteve të Pavarura, Steven Allen, vizitoi Shqipërinë nga 22 deri më 25 mars 2011, për të diskutuar mbi bashkëpunimin e ardhshëm të UNICEF-it me homologët shtetërorë të nivelit të lartë dhe me partnerët për zhvillim. Gjatë vizitës, ai vizitoi Linjën Kombëtare të Telefonit të Ndihmës për Fëmijë – ALO 116 e cila funksionon prej dy vjetësh. Kjo linjë telefonike është falas dhe punon pa pushim çdo ditë të javës. Mbi 150 000 fëmijë në vit telefonojnë për ndihmë dhe informacion. Kjo linjë telefonike përdor numrin mbarevropian, 116. Nevoja për linja telefonike ndihme është evidentuar edhe në rekomandimet e BE-së. Z. Alen kërkoi të dinte se si ALO 116 lidh fëmijët me institucionet dhe shërbimet publike. Ai theksoi rëndësinë dhe ndikimin e këtij shërbimi në jetën e fëmijëve, si edhe nevojën për mbështetje të qëndrueshme publike dhe private të ALO 116. Drejtori Rajonal vizitoi edhe “Shtëpinë e Ngjyrave”, një qendër shumëfunktionale e hapur nga bashkia dhe e mbështetur nga UNICEF-i për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, negli-

zhenca, dhuna dhe shfrytëzimi. Përfituesit kryesorë janë shtatë komunitete rome dhe egiptiane në Tiranë, me një total prej 234 familjesh me 530 fëmijë dhe 467 të rritur. Fëmijët dhe familjarët e tyre përfitojnë mbështetje psiko-sociale e juridike, shërbime shëndetësore, ushqime dhe aktivitete edukative. Një ekip i posaçëm punon në komunitete dhe rrugë për të evidentuar rastet e reja dhe për t'i dhënë mbështetje. Qendra ofron shërbime urgjence 24 orë për shumë fëmijë të rrugës.



Foto: Seminaret për aspektet juridike të çështjeve të abuzimit/keqtrajtimit të fëmijëve të organizuara nga Prezenca e OSBE-së dhe Ambasada franceze

OSBE dhe OJF shqiptare paraqesin raportin e anti-trafikimit

Në evenimentin e organizuar më 3 mars 2011 në Tiranë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Qendra shqiptare për Nisma Ligjore Qytetare prezantuan tre raporte në lidhje me situatën e viktimave të trafikimit: (i) përkthimin shqip të Kompensimi për Personat e Trafikuar dhe të Shfrytëzuar në Rajonin e OSBE-së, të përgatitur nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe Të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Aty jepet një tablo krahasuese e aksesit në sistemin e drejtësisë të viktimave të trafikimit në Shqipëri dhe në Shtete të tjera pjesëmarrëse të OSBE-së; (ii) një projekt-vlerësim i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me Konventën e Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i pari instrument juridik ndërkombëtar për të drejtat e njeriut që vendos një ekuilibër më të mirë mes procedimit gjyqësor të krimit dhe mbrojtjes së të drejtave të viktimave; (iii) një studim të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare për zbatimin e ligjit dhe performancën e autoriteteve gjyqësore në mbrojtje të të drejtave të viktimave. Studimi thekson nevojën që

sistemi gjyqësor shqiptar të vijojë punën për të përmbushur standardet ndërkombëtare me qëllim që viktimat e krimit, sidomos ato të krimeve të dhunshme, të gëzojnë të drejtën e dëmshpërblimit ose nga shkelësi i ligjit, ose nga shteti. Në këtë eveniment ishin të pranishëm përfaqësues të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Dhomës së Avokatit dhe policisë.

Prezenca e OSBE-së dhe Ambasada Franceze organizojnë seminare trajnuese për aspektet juridike të çështjeve të abuzimit/keqtrajtimit të fëmijëve.

Më 15-18 mars 2011, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në bashkëpunim me Ambasadën franceze organizuan seminare trajnuese në Tiranë dhe Shkodër për aspektet juridike të çështjeve me fëmijë të abuzuar dhe të keqtrajtuar. Seminaret u dhanë nga dy eksperte, Vjollca Meçaj, Drejtoreshë

Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Hel-sinkit dhe Marie-Anne Baulon, magjistrate franceze me përvojë të gjerë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Të pranishëm në këtë eveniment ishin gjyqtarë, prokurorë, oficerë policie, punonjës socialë dhe punonjës të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve, të cilët ngritën pyetje dhe problematika të ndryshme për çështjet e abuzimit/keqtrajtimit të fëmijëve. Qëllimi i këtyre seminareve ishte përmirësimi i hallkave të bashkërendimit/bashkëpunimit ndërmjet të gjithë profesionistëve si edhe tërheqja e vëmendjes në ndjeshmërinë e këtyre çështjeve, me qëllim që të kuptohet më mirë se si duhet të bëhet administrimi i provave dhe si duhet të zhvillohet hetimi për çështjet e keqtrajtimit të fëmijëve. Ekspertët prezantuan para pjesëmarrësve Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të miratuar në nëntor 2010.

Shpallet Fushata Kombëtare kundër Dhunës në Shkolla

Më 1 mars 2011, Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpalli fushatën “Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive”. Ky program 4-vjeçar i mbështetur nga UNICEF përdor komunikimin si strategji për ndryshimin e sjelljeve nëpër shkolla me qëllim uljen e dhunës. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Myqerem Tafaj, theksoi rëndësinë që ka për zhvillimin e fëmijëve si shkolla miqësore ashtu edhe mjedisi jo i dhunshëm. Ministri nxiti mësuesit dhe prindërit që të ndjekin mënyra të reja disiplinimi dhe metoda jo të dhunshme komunikimi me nxënësit. “Kjo alternativë e re do t’u shërbejë jo vetëm mësuesve, prindërve dhe nxënësve, por është një alternativë gjithëpërfshirëse për mbarë komunitetin dhe shoqërinë”, tha z. Tafaj. Përfaqësuesi i UNICEF-it në Shqipëri, Detlef Palm, nënvizoi rëndësinë e shembujve pozitivë dhe ndikimin e tyre në shkollë e familje. “Ne të gjitha duam më të mirën



Foto: OJF-ja shqiptare paraqet raportin e anti-trafikimit

për fëmijët tanë; mënyra më e mirë për ta trajtuar dhunën ndaj apo mes fëmijëve, është ta ndalojmë para se të ndodhë”, tha z. Palm. Ai shtoi se mekanizmat për mënyra alternative disiplinimi janë të shumtë dhe se prindërit e mësuesit duhet të japin shembullin e tyre. Programi do të zbatohet në të gjitha institucionet e arsimit parashkollor. Pjesë e këtij programi janë 4 050 mësues të arsimit parashkollor, 25 970 mësues të arsimit bazë dhe 8 180 mësues të arsimit të mesëm, si edhe të gjithë edukatorët dhe mësuesit e institucioneve të kujdesit për fëmijët. Nga ky program do të përfitojnë edhe rreth 400 000 nxënës të arsimit bazë dhe 136 200 nxënës të arsimit të mesëm.

Bordi Rajonal i Prindërve: Konsolidimi i pjesëmarrjes së prindërve në arsim në Kukës, Korçë dhe Gjirokastrë

Bordi Rajonal i Prindërve organizoi gjatë muajve shkurt-mars 2011 diskutime me prindërit, mësuesit, nxënësit, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të pushtetit vendor për projekt-ligjin për Arsimin Parauniversitar si edhe për dispozitat e reja normative. Me ndihmën e ekspertëve po përgatiten rekomandime që do t'i paraqiten Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në dy vitet e fundit, UNICEF ka mbështetur ngritjen e Bordit Rajonal të Prindërve të atashuar në Drejtoritë Arsimore Rajonale të Kukësit, Korçës dhe Gjirokastrës, me qëllim qartësimin e përgjegjësisë dhe rritjen e rolit të prindërve në praktikën dhe politikën arsimore.

Qeveria dhe shoqëria civile takohen për monitorimin e të drejtave të fëmijëve

Përfaqësues nga 12 këshillave qarku, zyrtarë nga 9 Njësi rajonale për të Drejtat e Fëmijëve dhe homologët e tyre të shoqërisë civile të angazhuar në Observatorët e Të Drejtave të Fëmijëve u takuan më 17 mars 2011 për të shkëmbyer njohuritë dhe përvojat në vlerësimin e situatës së fëmijëve në qarqet e tyre përkatëse. Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve i miratuar në vitin 2010, përcakton se organet në nivel qarku duhet të bashkërendojnë politikën që ndikojnë në garantimin e të drejtave të fëmijëve. UNICEF mbështeti organizimin e takimit konsultativ “Zhvillimi i Mekanizmave Rajonale për Të Drejtat e Fëmijëve”, ku

pjesëmarrësit theksuan nevojën e harmonizimit të përpjekjeve të politikëbërëse, ekzekutivit, shoqërisë civile dhe qytetarëve, pasi “çështjet e fëmijëve janë çështje të shoqërisë”.

Prezenca e OSBE-së i jep KQZ-së kompjutera në prag të zgjedhjeve vendore



Foto: Prezenca e OSBE-së i jep kompjutera Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri i dha 35 kompjutera Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) më 30 mars 2011, të cilët do të përdoren për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve të 8 majit. Kompjuterat, që do t'i kthehen Prezencës pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve, do të përdoren kryesisht nga komisionet e nivelit të mesëm, Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe Zyrat Ra-

jonale Zgjedhore të KQZ-së. Kompjuterat ofrohen si pjesë e asistencës teknike që Prezenca i jep Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo asistencë synon të ndihmojë organet e administrimit të zgjedhjeve të përmirësojnë punën e tyre dhe të rrisin profesionalizmin. Gjithashtu, Prezenca e OSBE-së ka financuar spote televizive dhe fletëpalosje të prodhuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të cilat informojnë votuesit për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin zgjedhor. Po ashtu, Prezenca ka kontraktuar një ekspert për të mbështetur drejtorinë e trajnimit dhe edukimit në KQZ, si dhe ka financuar shtypjen e Kodit Zgjedhor dhe të dokumenteve të tjera për KZAZ-të.

ICITAP mundëson dhurimin e jelekëve antiplumb për Policinë e Shtetit

Më 16 mars 2011, zv.Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara, Debora A. Jones, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Hysni Burgaj dhe Menaxheri i Programit Ndërkombëtar të Ndihmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal i Shteteve të Bashkuara (ICITAP), Gary Bullard, bënë nënshkrimin e rastit për dhurimin e 2 036 jelekëve antiplumb për policinë. Ky donacion u mundësua falë përpjekjeve të përbashkëta të Gardës Kombëtare Ushtarake të Nju Xherisit, Zyrës së Sherifit të Kontesë Bergen dhe Zyrës për Çështjet Dypalëshe të Komandës së SHBA-së për Evropën. Gjatë një vizite të mëparshme në Shqipëri, inspektori Michael Bradley i Zyrës së Sherifit të Kontesë Bergenit dhe koloneli Kevin Hegary i



Foto: Zv.Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara, Debora A. Jones, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Hysni Burgaj dhe Menaxheri i Programit Ndërkombëtar të Ndihmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal i Shteteve të Bashkuara (ICITAP), Gary Bullard nënshkruajnë për dhurimin e 2 036 jelekëve antiplumb.

Gardës Kombëtare Ushtarake të Nju Xhersit mësuan për nevojën e Policisë së Shtetit për jelekë mbrojtës dhe filluan përpjekjet për grumbullimin e pajisjeve të tepërta të organeve të zbatimit të ligjit dhe njërive ushtarake në mbarë shtetin e Nju Xhersit. ICITAP iu bashkua kësaj nisme dhe siguroi mbështetje administrative dhe financiare për transportimin e mbi 90 tonëve jelekë antiplumb në Shqipëri. Jelekët janë të llojeve të ndryshme, që nga modelet e lehta, deri të modelet që vishen nën uniformë si edhe jelekët e rëndë për ndërhyrje taktike. Veshjet antiplumb iu shpërndanë njërive të policisë, përfshi RENEA-n, njërive të operacioneve speciale dhe njërive të infiltrimit.

PAMECA III organizon Trajnim për Hetimin e Aseteve të Krimit

Gjatë tri javëve të para të marsit 2011, PAMECA III organizoi tre trajnime në kuadrin e komponentit Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar. Trajnimet u drejtuan nga dy ekspertë britanikë të krimit financiar, Stephen Maxwell dhe Ronnie McMurrin. Të dy ekspertët zotëronin përvojën e duhur në këtë fushë, pasi kanë shërbyer si hetues të lartë policorë kundër krimit të organizuar për mëse 30 vjet, kohë gjatë të cilës janë angazhuar edhe në detyra ndërkombëtar. Pjesëmarrësit ishin kryesisht studentë që u trajnuan nga Sektori për Hetimin e Aseteve të Krimit pranë Departamentit kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Policinë e Shtetit. Të pranishëm në trajnim ishin edhe punonjës të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të Njësisë së Inteligjencës Financiare pranë Ministrisë së Financave dhe të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Në secilin kurs u dhanë prezantime mjaft të dobishme nga një gjyqtar i Gjykatës së Krimeve të Rënda, një prokuror i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Drejtori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, NjIF, ILDKP dhe ekspertë vendas të hetimit të pasurive të krimit. Studentët u shprehën se kjo ishte një metodë shumë efektive trajnimi. “Mësua shumë gjëra të rëndësishme që do të na ndihmojnë të kemi sukses”, tha një nga hetuesit e Policisë së Shtetit. Kursi i fundit u përmbyll nga Lordi McNally, Ministër i Drejtësisë i Mbretërisë së Bashkuar dhe nga zv.Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Agron Kuliçaj.



Foto: UMinistri britanik Drejtësisë, Lord McNally mbështet trajnimin e PAMECA III

USAID Mbështet Avokatinë në Shqipëri

Më 7 mars 2011, USAID-i në partneritet me Dhomën Kombëtare të Avokatisë botoi përmbledhjen e parë të plotë të akteve juridike themelore që dispiplinojnë funksionimin e profesionit të avokatit në Shqipëri. “Kjo përmbledhje është një referencë e vlefshme për çdo avokat”, tha kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Maksim Haxhia, duke shprehur vlerësimin për ndihmesën e USAID-it në publikimin e saj. Botimi përmban Ligjin për Avokatinë (i ndryshuar), Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Kodin Etik të Avokatit, duke kontribuar kështu në rritjen e ndërgjegjësisimit mes avokatëve për këto

akte themelore, si dhe në njohjen më të mirë nga publiku për profesionin e avokatit në Shqipëri. Përveçse për Dhomën Kombëtare të Avokatisë, përmbledhja është e disponueshme për çdo avokat aktiv në të 12 dhomat e avokatisë në rrethe, ashtu si dhe në 22 gjykatat e rrethëve gjyqësore. Një kopje elektronike e këtij botimi mund të shkarkohet nga faqja e USAID Albania, në adresën: <http://albania.usaid.gov/JuST>. Nevoja për përgatitjen e një përmbledhjeje të tillë ishte një nga rekomandimet e dala nga diskutimet në 3 tryeza të rrumbullakëta mbi funksionimin e profesionit të avokatit në Shqipëri, të organizuara nga Programi i USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST) në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe me dhomat rajonale të avokatisë



Foto: Drejtori i Programi i USAID-it JuST, z. John Carver (djathtas) i dorëzoi kopjet e para të përmbledhjes së ligjeve dhe akteve juridike kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, z. Maksim Haxhia (majtas).

të Vlorës, Durrësit dhe Lezhës. Në këto tryeza të rrumbullakëta të zhvilluara gjatë periudhës dhjetor 2010 - janar 2011 morën pjesë mbi 100 avokatë nga këto dhoma, si dhe nga ato në qarqet përreth. Në kuadrin e projektit JuST, USAID-i po ndërmerr nisim të rëndësishme në mbështetje të avokatisë në Shqipëri. Ndër to është hartimi dhe zbatimi i një programi të Trajnimit të Vazhdueshëm Juridik, botimi i Revistës së Avokatisë, organizimi i një Konference Vjetore të Avokatëve Shqiptarë, si edhe ngritja e mekanizmave në mbështetje të përgatitjes së avokatëve të rinj, si krijimi i programit të klinikës juridike në Fakultetin Juridik, Tiranë dhe bashkërendimi i një programi stazhi për studentët e juridikut në institucione shtetërore e private. Projekti 5-vjeçar i USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST) që ka filluar në tetor 2010, synon të rritë transparencën, paanshmërinë dhe efektshmërinë e gjykatave, të konsolidojë rolin mbikëqyrës dhe antikorrupsion të organizatave të shoqërisë civile dhe medias, si dhe të forcojë avokatinë dhe arsimin juridik në Shqipëri.

Gjermania mbështet ekonominë krijuese: Ftesë për projekt-propozime që të përfitojnë subvencionim deri në 15 000 euro për ekonominë krijuese në Shqipëri

Me ftesën për projekt-propozime të shpallur më 24 mars 2011, GIZ mbështet sipërmarrjet e ekonomisë krijuese, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe konkurrueshmërisë ndërkombëtare të pjesëmarrësve nëpërmjet rritjes së produkteve novatore dhe krijuese. Kjo është faza pilot e Programit për Rrjetin e Bizneseve Krijuese, që i përket një programi për promovimin e bizneseve strategjike që është përgatitur bazuar në rezultatet e një vlerësimi të bërë nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (METE), Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) dhe me mbështetjen e GIZ-it. Vjet u realizua inventari gjithëpërfshirës i ekonomisë krijuese shqiptare që identifikoi katër nënfusha kryesore: artizanati, dizajni, arti dhe reklamat. Në prezantimin e rezultateve të vlerësimit, Bashkim Sykja, Drejtor i Drejtorisë së Mbështetjes së Konkurrueshmërisë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, nënvizoi se ekonomia krijuese në Shqipëri ka potencial të konsiderueshëm për rritjen



Foto: Znj. Claudia Wiegeler, z. Ismail Beka, znj. Ulrike Gantzer-Sommer, znj. Zana Turku dhe z. Enno Bozdo

ekonomike dhe punësimin. Të katër nënfushat bashkë përbëjnë rreth 0.5% deri në 1% të PBB-së dhe ofrojnë punësim për rreth 0.5% deri në 1% të fuqisë punëtorëve. Përveç një nënfushe të pestë që janë shërbimet për bizneset, këto katër nënfusha janë fokusi i kësaj ftese për projekt-propozime për të zhvilluar formimin e rrjeteve të sipërmarrjeve krijuese, konkurrueshmërinë, profesionalizimin dhe novacionin e tyre

Në këtë kontekst, GIZ kërkon projekte që transformojnë proceset e trashëgimisë tradicionale në mallra dhe shërbime krijuese. Projektet e dorëzuara do të vlerësohen nga një juri në qershor. GIZ u formua më 1 janar 2011, duke sjellë ekspertizën e përbashkët të Deutscher Entwicklungsdienst (DED) gGmbH (Shërbimi Gjerman për Zhvillim), the Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit (GTZ) GmbH (Bashkëpunimi Teknik Gjerman) dhe Inwent - Ndërtimi i Kapaciteteve Ndërkombëtare, Gjermani.

Arbitrazhi Ndërkombëtar

Një nënkomponent i ri i GIZ-it (Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman) është krijuar në Fondin e Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – Reforma Ligjore, me vendim të Ministrisë gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Ky nënkomponent i ri do të përqendrohet në zbatimin rajonal të metodave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përfshi arbitrazhin. Kjo do të realizohet bashkërisht me UNCITRAL-in (Komisioni i OKB-së për Të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare) dhe me Institutin Gjerman të Arbitrazhit (DIS - Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.). Agjenda legjislativë e Shqipërisë përfshin edhe hartimin e akteve normative për arbitrazhin ndërkombëtar. Procedura hartuese ka filluar tashmë me përgatitjen e një letre politikash për të cilën

UNCITRAL ka dhënë komentet e veta. Ministria e Drejtësisë, nën këshillimin e GIZ-it, vendosi që hapi i dytë të ishte organizimi i një tryeze të rrumbullakët që u mbajt më 17 mars ku u ftuan të gjithë praktikuesit ligjorë të arbitrazhit (gjyqtarë, avokatë dhe anëtarë të komunitetit të biznesit). Qëllimi i saj ishte evidentimi i problemeve praktike me të cilat praktikuesit mund të përballen gjatë arbitrazhit ndërkombëtar. Rezultatet do të shërbejnë si bazë për grupin e punës që do të fillojë hartimin e procedurave.

Kalendari: Siç ndodh çdo vit, Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Reforma Ligjore që është projekt i GIZ-it, përgatiti të ashtuquajturin „kalendari ligjor“ për të gjitha vendet e rajonit të përfshira në Fondin e Hapur Rajonal (Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia). Çdo muaj i kushtohet një fushe të reformës ligjore dhe bëhet një skicë me tekst që shërben për të shpjeguar një çështje juridike. Tema e kalendarit 2011 është „Vazhdimësia dhe Ndryshimi“. Aty përfshihen nismat ligjore në proces, progresi i bërë me barazinë gjinore dhe parandalimin e konflikteve, integritimin evropian dhe ekonominë sociale të tregut. Disa kopje falas në shqip mund t'i gjeni në zyrën e Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – Reforma Ligjore, ose në adresën e e-mailit orflex-al@giz.de.

USAID dhe GIZ bashkëpunojnë për Zhvillimin e Kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Ujësllës-Kanalizimeve

USAID dhe GIZ bashkojnë forcat për të ndihmuar dhe trajnuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Ujësllës-Kanalizimeve. Në kuadrin e programit të Qeverisë për decentralizimin e Sektorit të Ujërave, ndërmarr

rjet e ujësjellësit kanë formuar korporata me pronësi publike nën administrimin e një Këshilli Mbikëqyrës. Për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre ndërmarrjeve në dobi të konsumatorëve, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të kenë ekspertizë në këtë fushë, njohuri për ligjet, politikat dhe aktet normative përkatëse dhe të veprojnë në bazë të parimeve të qarta dhe transparente. Në nëntor 2010, Enti Rregullator i Ujit, Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri dhe projekti i GIZ-it që mbështet Entin Rregullator të Ujit, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi ku përcaktohen aktivitetet e asistencës që mbështet anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në 10 bashki dhe më pas në të gjitha ndërmarrjet. Me kontributin e konsiderueshëm të Entit Rregullatorit të Ujit, GIZ dhe USAID kanë mbështetur hartimin e një Manuali dhe Udhëzuesi Trajnimi për Këshillin Mbikëqyrës. Më 29 mars dhe 1 prill 2011, USAID sponsorizoi trajnimet fillestare për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nga 10 bashki: Elbasan, Fier, Fushë-Krujë, Gramsh, Korçë, Kukës, Lezhë, Librazhd, Pogradec dhe Shkodër. Në të ardhmen, Enti Rregullator i Ujit do të bashkëpunojë me të gjithë aktorët kryesorë dhe do të udhëheqë përditësimin periodik të Manualit duke pasqyruar ndryshimet e ligjeve, akteve normave dhe të kushteve. Aktualisht po përgatitet një marrëveshje formale ndërmjet Entit Rregullator të Ujit dhe Shoqatës së Ujësijellës-Kanalizimeve të Shqipërisë ku do të përcaktohen modalitetet e përditësimit dhe zbatimi i aktiviteteteve të ardhshme trajnuese.

Italia mbështet Reformën e Sistemit Shëndetësor

Muaji mars ishte i pasur me evenimente në sektorin e shëndetësisë, të mbështetur nga Kooperacioni Italian për Zhvillim, gjë që dëshmon për përkushtimin italian në këtë fushë. Në datat 17-20 mars u zhvillua kursi i tretë rezidencial i organizuar nga Shkolla Evropiane e Mjekësisë Transfuzionale. Kjo konferencë u mbajt në kuadër të programit “Zhvillimi i Mjekësisë Transfuzionale në Shqipëri drejt standardeve cilësore evropiane”, një projekt 3-vjeçar i cili përmes binjakëzimit të qendrave transfuzionale italiane me qendrat homologe shqiptare dhe përmes organizimit të kurseve formuese në Shqipëri dhe Evropë, ka për qëllim të ndërtojë një sërë kriteresh bazë të mjekësisë transfuzionale shqiptare për të garantuar nivel sigurie të pranueshëm në



Foto: Kryetari i Entit Rregullator të Ujit, Avni Dervishi dhe drejtuesi i programit të USAID për Qeverisjen Vendore në Shqipëri, David Smith hapin trajnimin

dhurimin e gjakut dhe të arrijë standardet evropiane në këtë fushë specifike të mjekësisë. Më 23 mars u mbajt Kongresi i 11-të Ndërkombëtarë i Anesteziologjisë dhe Reanimacionit, e promovuar nga Shoqata e Anestezistëve dhe Reanimatorëve të Shqipërisë, nën kujdesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Kooperacionit Italian. Konferenca mbledhi rreth 200 efektivë mjekësorë, duke iu ofruar mundësinë të shkëmbejnë praktikat më të mirat dhe ekspertizën për anestezi, terapinë intensive, menaxhimin e dhimbjes dhe barnat për emergjenca. Konferenca forcoi aftësitë profesionale të personelit shëndetësor, duke mbështetur kështu përmirësimin e cilësisë së shërbimeve mjekësore. Më pas, më 25 mars u mbajt Konferenca e Dytë për Kontrollin Farmaceutik e organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave me mbështetjen e Kooperacionit Italian. Kjo konferencë që mbledhi rreth 200 pjesëmarrës, e zgjeroi fushën e hulumtimit të konferencës së mëparshme, duke u fokusuar sivjet në reformat e nevojshme normative për të realizuar harmonizimin me standardet evropiane dhe standardizimin në këtë sektor. Me forcimin e edukimit të vazhdueshëm dhe

standardizimit, Kooperacioni Italian vazhdon të mbështetë përmirësimin e shërbimit shëndetësor në Shqipëri dhe të nxitë angazhimin e Qeverisë në garantim të të drejtës së çdo qytetari për të gëzuar standardet më të larta shëndetësore të mundshme.

BE financon për të afruar Bankën e Shqipërisë me bankat kombëtare të BE-së

Projekti i binjakëzimit me vlerë 1 milion euro ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave kombëtare të Italisë dhe Francës u lançua më 23 mars 2011. Ky projekt i financuar nga BE-ja do të përmirësojë praktikat e punës së Bankës së Shqipërisë për t'i harmonizuar me praktikat e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Projekti do t'i sjellë sistemit bankar shqiptar ekspertizën e BE-së dhe përvojën e dy prej vendeve themeluese të BE-së dhe do të trajnojë specialistët e Bankës së Shqipërisë që të forcojnë kontributin për integrimin ekonomik të vendit në BE. Binjakëzimi mes Bankës së Shqipërisë, Banca d'Italia dhe Banque de France do të mundësojë hartimin dhe



Foto: Drejtori i Kooperacionit Italian, Aldo Sicignano në hapjen e Kongresit të 11-të të Anesteziologjisë dhe Kujkësimit Kritik, Tiranë, 23 mars 2011.

zbatimin e një plani për rritjen e kapaciteteve të Bankës së Shqipërisë në çështje si Mbikëqyrja dhe Stabiliteti Financiar, Koordinimi i Procesit të Integritimit Evropian, Edukimi Financiar, Sistemet e Pagësave, Statistikat dhe Tregu Ndërbankar. Fuqizimi i funksioneve mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë është thelbësor për një funksionim më të mirë të sistemit bankar të cilit bizneset do të mund t'i besojnë. Kriza e fundit ekonomike dhe financiare e ka rritur rëndësinë e rolit të bankave qendrore për garantimin e stabilitetit ekonomik. Gjatë ceremonisë së prezantimit, Shefi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ambasadori Ettore Sequi vuri në dukje rëndësinë e praktikave të harmonizuara në kontekstin e globalizimit. Ai theksoi se “një investim i tillë nga BE-ja është një tjetër tregues i seriozitetit më të cilin e kemi marrë të ardhmen evropiane të Shqipërisë. Jam i lumtur që banka qendrore e Shqipërisë do të ndihmohet nga bankat qendrore të Italisë dhe Francës për t'u përgatitur për integrim ekonomik me BE-në, pasi ky është pikërisht një hap drejt integritimit ekonomik me vendet anëtare të BE-së”. Projekti prej 1 milion eurosh do të vazhdojë deri në maj 2012 dhe do të zbatohet nga bankat qendrore të Italisë dhe Francës.

Takimi i parë me partnerët për programin operacional të zhvillimit të burimeve njerëzore

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në bashkëpunim me projektin e financuar nga BE-ja, “Faciliteti për Përgatitjen e Projekteve (PPF)” të zbatuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim, organizoi takimin e parë konsultativ me partnerët më 23 mars 2011, për të diskutuar rreth draftit të parë të Programit Operacional shqiptar për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, i cili është dokument programimi për komponentin IV të IPA-s (Zhvillimi i Burimeve Njerëzore). Takimi u kryesua nga Kryetari i Strukturës Operuese të Komponentit IV të IPA-s, zv.Ministri Kastriot Sulka. Pjesëmarrës në këtë takim ishin zv.Ministrja e Integritimit, Jorida Tabaku, Shefi i Operacioneve të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Luigi Brusa dhe përfaqësues të Agjencisë Austriake për Zhvillim. Folësit theksuan rëndësinë e procesit konsultativ për përfshirjen e tërë partnerëve që të kontribuojnë në formësimin e Programit Operacional përmes dialogut konstruktiv. Takimi i parë informoi partnerët për qël-



■ Foto: Takim konsultativ për programin operacional të zhvillimit të burimeve njerëzore, mbajtur më 23 mars 2011

limet e Programit Operacional në ndihmë të forcimit të kapaciteteve administrative në lidhje me menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e burimeve për Fondin Social Evropian. Stafi i Ministrisë dhe ekspertët e PPF-së prezantuan prioritetet dhe masat e Programit Operacional në fushën e punësimit, arsimit dhe përfshirjes sociale, të cilat do të bashkëfinancohen me burime të BE-së sapo Shqipëria të marrë statusin e vendit kandidat. Komentet dhe propozimet e partnerëve sociale do të përfshihen në draftet e ardhshme. Sipas një plani veprimi, drafti i parë i Programit Operacional do t'i dorëzohet strukturave përkatëse të KE-së më 4 prill 2011. Drafti i dytë pritet t'i dërgohet Komisionit në korrik 2011, ndërsa versioni përfundimtar do t'i dorëzohet në dhjetor 2011. Dy takime më të gjera konsultative publike me shoqërinë civile dhe aktorët kryesorë do të organizohen në muajt në vijim. Drafti i dytë i Programit Operacional do të afishohet në faqet e internetit të ministrive dhe do të jetë i hapur për publikun.

Përmbauesit trajnohen për Monitorimin dhe Kontrollin

Në mbështetje të zbatimit të ligjit për shërbimin përmbaues privat dhe për forcimin e kapaciteteve të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Privatë dhe rritjen e nivelit profesional të përmbauesve privatë, Projekti për Reformën e Përmbaimit në Ballkan (BERP) në bashkëpunim me EURALIUS, kanë kohë që mbështesin shërbimin përmbaues privat dhe shtetëror. Në mars 2011, 20 përmbaues shtetërorë dhe 20 përmbaues privatë morën pjesë në trajnimin për çështje të monitorimit e kontrollit dhe mënyrat sesi shërbimet përmbaimore duhet të krijojnë organizma në funksion të mirëfunksionimit. I pranishëm ishte edhe zv.Kryetari i Parë i UIHJ-së, Bernard Menu. U diskutuan çështje të ndryshme si trajnimi i vazhdueshëm i përmbauesve

dhe infrastruktura e nevojshme për këto trajnime, si dhe u identifikuan kandidatët potencialë. Për këtë qëllim, po hartohet një plan veprimi që do t'u paraqitet të dy shërbimeve shumë shpejt. Trajnimi u mbështet nga Projekti për Reformën e Përmbaimit në Ballkan, projekt ky i financuar nga Qeveria holandeze dhe i zbatuar nga Qendra Holandeze për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në bashkëpunim me GIZ dhe UIHJ si edhe nga EURALIUS në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Përmbauesve Privatë dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaimit.

Qeveria përfundon Anketën mbi Monitorimin e Deklaratës së Parisit për vitin 2011

Qeveria ka përfunduar Anketën mbi Monitorimin e Deklaratës së Parisit për vitin 2011 dhe i ka dorëzuar OECD/DAC-it të gjitha raportet dhe pyetësorët e kërkuar. Për ta finalizuar këtë anketë, Qeveria mbledhi komunitetin e donatorëve dhe shoqërinë civile në një takim konsultativ të zhvilluar më 30 mars 2011. Në këtë takim të kryesuar nga Drejtorja e DEBASKON-it, Valbona Kuko, diskutimet u fokusuan në rezultatet paraprake të anketës, duke vlerësuar se sa janë arritur angazhimet në kuadër të Deklaratës së Parisit. Pastaj u prezantuan rezultatet kryesore të anketës monitoruese 2011, bazuar në Pyetësorin e Qeverisë, Tabelën e të Dhënave dhe Raportin për Shqipërinë, si pjesë përbërëse të anketës. Në takim u diskutuan edhe modulet fakultative shtesë: modulet për Barazinë Gjinore dhe Efikasitetin e Ndihmës, për Pronësinë Përfshirëse dhe Përgjegjshmërinë e Ndërsjellë që janë plotësuar nga Qeveria. Dy modulet e para, të përfunduara, iu dërguan Sekretariatit të OECD/DAC. Ndërsa moduli i tretë, Përgjegjshmëria e Ndërsjellë që ishte pjesë e Forumit të Bashkëpunimit për Zhvillim të OKB-së, që synon përmirësimin e efektshmërisë dhe koherencës

së bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim, iu dorëzua Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së. Anketa 2011 i ka dhënë një mundësi Qeverisë dhe partnerëve të saj për zhvillim që të forcojnë rolin e tyre në menaxhimin dhe bashkërendimin e ndihmës. Rezultatet e Anketës 2011 që pritet të dalin në mesin e majit, shërbejnë si kontribut për të parë ecurinë e përgatitjeve për Forumin e Katërt të Nivelit të Lartë për Efikasitetin e Ndihmës që do të mbahet në Busan të Koresë, më 8 dhjetor 2011.



Foto: Përfaqësuesit e lartë të Qeverisë shqiptare, Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Republikën Federale të Gjermanisë, Valter Ibrahim, Zv/Ministri i Financave, Nezir Hakleca, Drejtorja e DEBASKON-it, Valbona Kuko, dhe Zv/Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Sokol Dervishaj gjatë vizitës së punës në Gjermani

Përfaqësues të lartë të Qeverisë shqiptare kryejnë një vizitë pune në Gjermani

Me ftesë të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, një delegacion me përfaqësues të lartë të Qeverisë shqiptare ishte me një vizitë pune në Gjermani në datat 9-12 mars 2011. Qëllimi i vizitës ishte diskutimi dypalësh për ecurinë e projekteve aktualisht në zbatim dhe përgatitjen e konsultimeve teknike që parashikohen të organizohen në tetor të këtij viti. Delegacioni shqiptar përbëhej nga përfaqësues të DEBASKON-it dhe Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme. Takime të nivelit politik dhe teknik u mbajtën në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), zyrën qendrore të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, dhe Zyrën Qendrore për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). Përfundimet kryesore nga takimet e nivelit teknike me KfW dhe GIZ ishin: (i) Energjia konsiderohet një nga sektorët më të rëndësishëm të bashkëpunimit me KfW, me një portofol “të rëndë” prej 180 milion eurosh në projekte aktuale dhe 50 milion euro në angazhime të ardhshme. Gjithashtu një fond prej 30 milion eurosh është planifikuar për linjat e transmetimit; (ii) Sektori i ujësjellës-kanalizimeve është një tjetër sektor prioritar i bashkëpunimit, duke gjykuar nga investimet e akorduara që kapin vlerën totale prej 227 milion eurosh që nga fillimi i bashkëpunimit në fillimin e viteve ‘90; (iii) Për sa i përket ekonomisë, pala gjermane u njoh me situatën aktuale të këtij sektori, si miratimi i Programit Strategjik për Zhvillimin e Novacionit dhe Teknologjisë së NVM-ve. Në zbatim të kësaj të fundit u kërkua mbështetje e mëtejshme për NVM-të për funksionimin e Fondit të Novacionit në favor të shërbi-

meve të biznesit, sikurse sipërmarrjet për promovimin e inkubatorëve teknologjisë dhe klasterave industriale; (iv) Në bashkëpunim me Programin IPA, Qeveria gjermane, nëpërmjet GIZ-it, do të vazhdojë të mbështetë zhvillimin e arsimit profesional, më fokus të veçantë zhvillimin e qendrës arsimore në Kamëz, gjithashtu në vazhdimin e projektit për fuqizimin e Fakultetit e Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) në Durrës dhe aktivitetet e ndërmarra në Shqipërinë Verilindore.

Në përfundim, DEBASKON-i prezantoi situatën e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe theksoi rëndësinë e orientimit drejt një numri më të vogël projektesh, por me financim të mjaftueshëm, në mënyrë që të arrihet impakti i dëshiruar. Thelbësor është koordinimi dhe përdorimi i strukturave shtetërore shqiptare për projekte me financim të huaj, pasi kjo është e nevojshme për të rritur efektshmërinë dhe qëndrueshmërinë e asistencës së huaj.

Monitorimi i impaktit dhe vazhdimësisë së procesit të SPI-së

Fondi i Besimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili mbështetet nga shtatë donatorë (Britania e Madhe, Austria, BE, Italia, Holanda, Suedia dhe Zvicra) për të mundësuar që procesi i SPI, metodologjia dhe produktet e tij të kuptohen dhe të zbatohen sa më mirë nga Qeveria, do të përfundojë në fund të shtatorit. Ky Fond është menaxhuar nga Banka Botërore dhe ka financuar elementë të ndryshëm që synonin të forconin kapacitetet në agjenci të ndryshme shtetërore për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar, duke u siguruar se politikat kyce të qeverisë dhe proceset financiare të zhvillohen në një mënyrë të integruar. Programi synonte të ndihmonte zbatimin efektiv të principeve të

SPI-së në të gjitha nivelet e Qeverisë. Për të analizuar rezultatet e arritura deri tani dhe për të vendosur themelet për vazhdimësinë e mbështetjes së donatorëve ndaj zbatimit të SPI-së përtej shtatorit, më 24 deri 26 mars 2011, Banka Botërore dhe CFCU organizuan një seminar për zyrtarët e qeverisë në Budva të Malit të Zi. Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues të DEBASKON-it, Ministrisë së Financave, CFCU, Departamentit të Administratës Publike, Institutit të Trainimeve të Administratës Publike, dhe AKSH-it. Aktiviteti kryesor që u zhvillua gjatë këtij evenimenti ishte seminari me temë “*Monitorimi i impaktit dhe vazhdimësisë së procesit të SPI-së: Analizimi i Matricës së Rezultateve*”. Seminari diskutoi progresin e bërë drejt plotësimin të të gjithë komponenteve të Fondit të Besimit të SPI-së dhe duke u bazuar në Matricën e Rezultateve, analizoi impaktin e mbështetjes së dhënë nga ky Fond për ministritë e linjës dhe agjencitë qeveritare përfituese. Ky seminar theksoi edhe njëherë se për shumicën e proceseve të SPI-së që mbështeten nga Fondi i Besimit janë arritur rezultate pozitive dhe mbështeti idenë e vazhdimësisë për të mundësuar që këto rezultate pozitive të mund të thellohen. Aktualisht, SPI ka kaluar nga faza e dizenjimit në atë të zbatimit dhe duke vlerësuar progresin e bërë deri tani qeveria e konsideron të një rëndësie të lartë vazhdimësinë në një fazë të dytë të Fondit të Besimit të mbështetur nga donatorët. Gjatë fazës së dytë, Fondi i Besimit mund të fokusohet në një numër më të vogël komponentesh dhe si rrjedhojë të mund të arrijë rezultate më të larta. Në seminar u diskutuan disa propozime dhe ide që do të mund të ndihmojnë Qeverinë të identifikojë fushat që kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme. Gjatë muajve të ardhshme Qeveria do të hartojë një plan konkret të nevojave dhe prioriteteve të saj. Ky plan do të prezantohet për donatorët në mënyrë që të mundësohet mbështetja financiare e tyre dhe të vazhdohet zbatimi i procesit të SPI-së.

BANKA BOTËRORE

Një mision i Bankës Botërore vizitoi Tiranën nga 28 marsi deri më 1 prill 2011 për të përpiluar një Vlerësim për Shpenzimet Publike dhe Përgjegjshmërinë Financiare (PEFA). Qëllimi i misionit ishte që të diskutonte me Ministrinë e Financave dhe partnerët e tjerë në lidhje me modalitetet për përditësimin e vlerësimit PEFA të vitit 2006. Misioni arriti të përcaktonte (a) kur dhe ku mund të realizohej PEFA; dhe (b) mbështetjen financiare dhe aktivitetet potenciale mbështetëse për reformën në menaxhimin financiar publik.

Një Mision vlerësimi paraprak i Projektit për Investimet në Sektorin e Ujërave zhvilloi një vizitë në datat 14-18 mars 2011. Qëllimet kryesore të misionit ishin: (i) të takonte homologët e Qeverisë dhe aktorët kryesorë për të vlerësuar ecurinë e përgatitjes së projekteve; (ii) të analizonte të dhënat bazë të grumbulluara dhe problematikat kryesore të sektorit; (iii) të diskutonte me aktorët kryesorë dhe partnerët donatorë për prioritetet e politikave të strategjisë së re sektoriale.

Misioni për Sistemin e Prokurimit Elektronik në kuadrin e Projekteve të Financuara nga Banka Botërore u realizua më 14-17 mars 2011. Qëllimet kryesore të misionit ishin: (i) të diskutonte me Agjencinë e Prokurimit Publik në lidhje me përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik; (ii) përcaktimi i hapave të mëtejshëm në kuadrin e komponentit besim të financimit të GPF; (iii) organizimi i konferencës për prokurimin elektronik dhe aktivitetet të tjera përkatëse; dhe (iv) projekti pilot me Fondin Shqiptar për Zhvillim për sistemin e prokurimit publik, financuar nga Banka Botërore.

Misioni për Asistencën teknike për Forcimin e Menaxhimit të Rrezikut të Përmbajtjeve; Projekti për Përballimin dhe Zbutjen e Rrezikut nga Katastrofat u zhvillua më 10-11 mars 2011. Në vijim të misionit vlerësues të janarit 2011 pas përmbajtjeve shkatërruese si dhe grantit të dhënë nga Global Facility për zbutjen e katastrofave dhe rikuperimin me qëllim financimin e asistencës teknike, misioni vlerësoi hapat e mëtejshëm që duhen ndjekur.

Misioni në lidhje me Nismën për Transparençë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) dhe Sektorin Minerar u realizua gjatë datave 8-11 mars 2011. Qëllimet kryesore të misionit ishin: (a) të takohej me Sekretariat

Misionet në vend

e ri të EITI-t për të diskutuar rreth masave kyçe për të arritur pikat vlerësuese në maj 2011, si dhe të diskutonin çështjet e Menaxhimit Financiar të BB-së dhe Udhëzimet për prokurimet; (b) t'i prezantonte Grupit të Punës Shumëpalësh procesin auditues/rakordues të EITI-t; (iii) të diskutonte me donatorët për mundësitë e shtimit të fondeve për EITI-n në Shqipëri.

Një Mision i Bankës Botërore për Fondin e Besimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe për Grantin e Facilitetit të Partneritetit me Qeverisjen vizitoi Shqipërinë më 7-11 mars 2011. Qëllimet kryesore të misionit ishin: (i) të takohej me Ministrinë e Financave dhe përfutuesit e tjerë të Fondit të Besimit të SPI-së (DEBASKON, DAP, AKShI, etj.) për të diskutuar rreth ecurisë dhe veprimet e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të Fondit të Besimit dhe arrijen e objektivave të tij; (ii) të takohej me përfaqësuesit e donatorëve për të diskutuar progresin e bërë drejt arritjes së objektivave të Fondit të Besimit të SPI-së. Në takimet e misionit me Qeverinë, mund të ftohen edhe përfaqësues të donatorëve; (iii) të organizojë një tryezë të rrumbullakët për të drejtat e pronësisë dhe masat mbrojtëse në lidhje me shpronësimet, në mënyrë që të disku-

tohen me Qeverinë konstatimet dhe rekomandimet e studimit kërkimor të Bankës Botërore për këto çështje, financuar nga Granti i GPF-së; dhe (iv) të organizojë një seminar për aplikimet e qeverisjes elektronike të financuara nga Granti i GPF-së.

Misioni mbështetës për zbatimin e Projektit për Menaxhimin dhe Administrimin e Tokës vizitoi Shqipërinë më 3-15 mars 2011. Qëllimin ishte që të analizohej progresi në zbatimin e masave të miratuara që nga misioni i kaluar, sidomos pas rristurimit të projektit muajin e kaluar, me synim përsheptimin e zbatimit të këtij projekti.

Misioni mbështetës i zbatimit të Projektit për Menaxhimin e Integruar dhe Pastrimin e Zonave Bregdetare zhvilloi një vizitë në datat 1-9 mars 2011. Qëllimi ishte të analizohej ecuria e zbatimit dhe masave të rëna dakord në tetor 2010. Vëmendje e veçantë iu kushtua investimeve për sheshgrumbullimin e inerteve në Sarandë, stacionit të transferimit në Himarë dhe rehabilitimit të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve të Sarandës që po has në vonesa shqetësuese, çka ka shkakuar shqetësim në lidhje me zbatimin e aktiviteteve brenda afatit të përfundimit të Projektit që është 31 dhjetori 2012.

dialoguqeveridonatorë

Nga data 15 dhjetor 2010 Banka Botërore mori Kryesimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim.

Të gjitha komentet lidhur me Dialogun Qeveri-Donatorë janë më se të mirpëritura!

Doni të kontribuoni?

Nëse dëshironi të kontribuoni, dërgoni tekstin tuaj në zyrën e Sekretarit Teknik të Donatorëve (nevila.como@aidharmonisation.org.al) ose në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (koordinimi@km.gov.al) deri më datë 5 të çdo muaji. Teksti duhet të jetë mundësisht rreth 100 fjalë.

Shpërndarja:

Çdo botim do t'ju dërgohet më datë 15 të çdo muaji.

Cilët janë donatorët në Shqipëri?

Për të zbuluar cilët janë donatorët që operojnë në Shqipëri, klikoni [këtu](#).

Për t'u çregjistruar:

Lutemi dërgoni e-mail tek Nevila Çomo (nevila.como@aidharmonisation.org.al)

Buletini "Dialogu Qeveri-Donatorë" mbështetet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

